



Prishtinë: 19.05.2016
Kodi i ZRRE-së: V_820_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1481_05_16**;

në seancën e mbajtur më datë 19.05.2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **APROVOHET** ankesa e konsumatorit A. D. (punëtori për punimin e drurit) nga Kamenica me shifër DGL – 9031567, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi;
- II **OBLIGOHET** KESCO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DGL – 9031567 nga korrigjimi nr.22806DGL-9031567 i datës 13.08.2014 në vlerë 1,998.92€.

A R S Y E T I M

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 04.05.2015 është parashtruar ankesa nga konsumatori A. D. (punëtori për punimin e drurit) nga Kamenica me shifër DGL – 9031567 për kundërshtimin e tij për ngarkesën e faturuar nga KEDS me datë 13.08.2014 në vlerë prej 1998.92€.

Me datë 18.07.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve matëse (GM) kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit 35715933 të cilin e kanë larguar nga matja për shkak të djegies, si dhe kanë vendosur për matje GM 35778658 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar në procesverbal të dhënave teknike të pikës matëse, si dhe kanë evidentuar që duhet të bëhet korrigjimi nga data e djegies së njehsorit elektrik.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 007423 të datës 18.07.2014

Me datë 07.08.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit GM 35778658 të cilin e kanë larguar nga matja për shkak të djegies, si dhe kanë vendosur për matje GM 978830397 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar në procesverbal të dhënave teknike të pikës matëse si dhe ka evidentuar që deri tek djegia e njehsorit elektrik ka ardhur si pasojë e zbrazjes atmosferike.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 005859 të datës 07.08.2014



Departamenti i faturimit në KESCO me datë 13.08.2014 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimin nr.22806DGL-9031567 në vlerë financiare **1,998.92€** duke bërë korrigjimin për periudhën 01.07.2014 deri më 08.08.2014 duke marr për bazë shpenzimin ditor të muajit paraprak.

Provë: Korrigjimi i KEDS-it nr. 22806DGL-9031567 i datës 13.08.2014

Me datë 21.01.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin nr.22806DGL-9031567 të datës 13.08.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit datë 21.01.2015

Me datë 23.01.2015 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbaleve mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 007423 të datës 18.07.2014 dhe nr. 005859 të datës 07.08.2014.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 23.01.2015

Me datë 04.05.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi nr. 22806DGL-9031567 e datës 13.08.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datës 04.05.2015

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar ZRRE-së ka theksuar se rreth datës 04-07.07.2014 ka njoftuar KEDS-in për djegien e njehsorit elektrik GM 35715933 dhe se ekipet e inspektimit kanë inspektuar pikën matëse ku kanë vulosur dorezën me qëllim të pamundësimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike, por që data e vulosjes nuk është dhënë nga konsumatori, por që thekson se me datë 09.07.2014 e ka parë vet të vulosur dorezën. Konsumatori në vazhdim të ankesës ka theksuar se njehsori elektrik GM 35715933 është larguar nga matja me datë 18.07.2014 bazuar edhe në procesverbalin e KEDS-it, por që edhe pas vendosjes së njehsorit elektrik GM 35778658 të nesërmen është vërejtur se njehsori nuk jep sinjal përkatësisht nuk bënë regjistrimin e energjisë së shpenzuar për çka edhe është njoftuar menjëherë KEDS. Për këtë periudhe ai deklaron se është punuar 4-5 orë me kapacitet, fuqi prej 60 kW. Te njëjtën dite ekipet e KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse ku kanë marr njehsorin elektrik GM 35778658 dhe kanë vulosur dorezën. Nga kjo periudhe e deri me datë 07.08.2015 kur edhe është vendosur për matje njehsori GM 97830397 ekipet e KEDS-it kanë vizituar trafon me shume se 10 here. Konsumatori deklaron se për këtë periudhe kohore pra për 39 ditë asnjë here nuk ka shfrytëzuar energjinë elektrike përveç me datë 19.07.2014

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE e datës 04.05.2015

ZRRE gjatë analizës së bërë procesverbalit të montimit dhe demontimit të grupit matjse ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve matëse me datë 18.07.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit GM 35715933 dhe gjatë inspektimit e kanë larguar nga matja grupin matës nr. 35715933 për arsyetë të djegies së tij, si dhe kanë vendosur për matje GM nr.35778658 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. në procesverbalin e lartëcekur punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar edhe të dhënat teknike të pikës matëse, si dhe kanë theksuar se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi nga data e djegies së njehsorit elektrik. Vlen të theksohet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk kanë evidentuar nëse ka ndodhur edhe djegia e Transformatorëve Matës Rrymor (TMRR), por që sipas të dhënave të evidentuara në procesverbal konstatohet se TMRR-të mbeten të njëjta 300/5, ku herësi i transformimit mbetet i njëjtë, pra C=60.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 007423 i datës 18.07.2014

Pas procesverbalit të cekur në lartë, Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin tjetër të montimit dhe demontimit të grupit matëse dhe ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për



inspektimin e Grupeve matëse prapë me datë 07.08.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit GM nr.35778658, dhe gjatë inspektimit kanë larguar nga matja GM nr.35778658 për shkak të djegies së tij, si dhe kanë vendosur për matje GM 97830397 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal të dhënave teknike të pikës matëse si dhe ka evidentuar që deri tek djegia e njehsorit elektrik ka ardhur si pasojë e zbrazjes atmosferike. Po ashtu sipas të dhënave të evidentuar në procesverbal konstatohet se TMRR-të mbeten të njëjta, pra herësi i transformimit është 300/5, apo C=60.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 005859 të datës 07.08.2014

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 13.08.2014 bazuar në procesverbalet e montimit-demontimit (ndërrimin) e grupit matës nr. 007423 datë 18.07.2014 dhe nr. 005859 datë 07.08.2014 përmes urdhër lejimit/korrigjimit nr.22806DGL-9031567 ka ngarkuar konsumatorin në vlerë shtesë prej **1,998.92€** për periudhën 01.07.2014 deri në periudhën 08.08.2014 (39 ditë) duke e faturuar konsumatorin në baza ditore bazuar në shpenzimin e periudhës qershor 2014. ZRRE me qëllim të sqarimit të konsumit (shpenzimit) të konsumatorit ka kërkuar nga sektori i AMR-së (ang. Automated Meter Reading) në KEDS të sigurohen të dhënave të lexuar nga njehsorët GM 35715933 dhe GM 35778658. Sipas raporteve të leximit të siguruara nga sektori i AMR-së për njehsorin GM 35715933 (njehsori i parë i djegur) konstatohet se të dhënave të shpenzimeve janë të regjistruara deri më datë 30.06.2014, kurse nga periudha 01.07.2014 deri me datë 18.07.2014 nuk ka regjistrim të shpenzimit të energjisë. Nga shkresa e lëndës vërehet se konsumatorit në fjalë me datë 18.07.2014 i është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe është vendosur për matje GM 35778658 (njehsori i dytë i djegur) dhe se sipas raporteve të dërguara nga AMR ka regjistrim të shpenzimit të energjisë vetëm me datë 19.07.2014, dhe se nga kjo periudhë e deri me datë 07.08.2014 kur edhe është vendosur për matje njehsori elektrik GM 97830397 nuk ka fare regjistrim të shpenzimit të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE gjithashtu ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe konstaton se gjendja e fundit e faturuar me njehsorin elektrik GM 35715933 përputhet plotësisht me gjendjen e fundit të lexuar me datë 30.06.2014 sipas raporteve të dërguara nga AMR.

Provë: Korrigjimin plotësues nr.74134DPR-90030016 i datës 23.04.2015 dhe raportet e leximit të KEDS-it (sektori i AMR-së)

Bordi i ZRRE-së bazuar në analizat e bëra dy procesverbaleve të ndërrimit të grupit matës nr.007423 të datës 18.07.2014 dhe nr.005859 të datës 07.08.2014, si dhe raporteve të leximeve nga AMR, ka kërkuar nga KEDS raport shtesë nga ekipi i KEDS-it i cili ka bërë ndërrimin e njehsorëve me datë 18.07.2014 dhe 07.08.2014. KEDS ka ofruar fotografitë e bëra nga pika matëse me datë 11.07.2014, 04.08.2014 dhe 07.08.2014, si dhe ka evidentuar që nuk ka të dhëna tjera, përveç procesverbaleve të ndërrimit të njehsorit, dhe se me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik për herën e dytë konsumatori ka qenë i kyçur dhe ka mundur të shfrytëzoj energjinë elektrike, por që nuk është evidentuar saktë nëse konsumatori ka qenë duke shfrytëzuar energji elektrike. Sipas fotografive të dërguara konstatohet se konsumatori ka pasur të djegur vetëm njehsorët elektrik GM nr.35715933 dhe GM nr.35778658 pasi që dëmtime të tjera nuk vërehen. Bordi i ZRRE gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës konsideron se faktet e ofruara nga KEDS nuk janë të mjaftueshme që të vërtetojnë se konsumatori nga periudha 01.07.2014 deri në periudhën 07.08.2014 ka shfrytëzuar energjinë elektrike (e cila nuk është regjistruar në njehsorët elektrik për shkak të djegies, përveç me datë 19.07.2014 ku shpenzimi në total është TL=15.46 kWh dhe TU=0.02 kWh e që shumëzuar me konstantë C=60 është TL=928 kWh dhe TU=1.32 kWh), dhe se bazuar në supozimin e shfrytëzimit të energjisë duhet edhe të ngarkohet me korrigjimin e supozuar pasi që ZRRE nuk ka pranuar asnjë dokument me të cilin do të vërtetohej se ekipet e KEDS-it kanë ndërmarrë veprime për parandalimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga ana e konsumatorit edhe në periudhat para ndërrimit të njehsorëve.



Provë: Fotografit nga inspektimi i pikës matëse datë 11.07.2014, 04.08.2014 dhe 07.08.2014 si dhe sqarimi i dërguar me email datë 26.04.2014

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka shqyrtuar edhe ankesën e konsumatorit, ku në ankesën e tij është theksuar se rreth datës 04-07.07.2014 ka njoftuar KEDS-in për djegien e njehsorit elektrik GM 35715933 dhe se ekipet e inspektimit kanë inspektuar piken matëse ku kanë vulosur dorezën me qëllim të pamundësimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike, por që data e vulosjes nuk është dhënë nga konsumatori, por që thekson se me datë 09.07.2014 e ka parë vet të vulosur dorezën. Konsumatori thekson se njehsori elektrik GM 35715933 është larguar nga matja me datë 18.07.2014 bazuar edhe në procesverbalin e KEDS-it, por që edhe pas vendosjes së njehsorit elektrik GM 35778658 të nesërmen është vërejtur se njehsori nuk jep sinjal përkatësisht nuk bënë regjistrimin e energjisë së shpenzuar për çka edhe është njoftuar menjëherë KEDS. Për këtë periudhë ai deklaron se është punuar 4-5 orë me kapacitet, fuqi prej 60 kW. Te njëjtën dite ekipet e KEDS-it kanë inspektuar piken matëse ku kanë marr njehsorin elektrik GM 35778658 dhe kanë vulosur dorezën. Nga kjo periudhë e deri me datë 07.08.2015 kur edhe është vendosur për matje njehsori GM 97830397 ekipet e KEDS-it kanë vizituar trafon me shume se 10 here. Konsumatori deklaron se për këtë periudhë kohore pra për 39 ditë asnjë here nuk ka shfrytëzuar energjinë elektrike përveç me datë 19.07.2014

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE e datës 04.05.2015

Pas analizimit të të gjitha dëshmive të prezantuara nga palët në kontest dhe Rekomandimin e paraqitur nga DMK, Bordi i ZRRE-së në mbeldhjen e mbajtur me datë 19.05.2016, vendosi që të **aprovoj** ankesën e konsumatorit për shkarkimin nga korrigjimi nr. 22806DGL-9031567 i datës 13.08.2014 në vlerë 1,998.92€. Andaj duke marr për bazë këtë dhe krejt atë që u theksua më lart u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Kompanisë A. D.
- KEK-ut, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.